

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objkti i Procedures: “Upgrade i teknologjise Hardware/Software si dhe perditesim te funksionaliteteve ne sistemin e matjes Mobiread”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 32428000-9 - Upgrade Rrjeti

VLERA E FONDIT LIMIT: 37,600,000 (Tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ne piken 1 te nenit 6 te ligjit 16/2024, “per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Qëllimi i kësaj procedure është të bëhet upgrade i sistemit MOBIREAD dhe teknologjitë përbërëse, ndërtimi i ndërfaqeve në teknologjinë HTML, rritja e sigurisë, të përmirësohen proceset aktuale të punës të sistemit MONIREAD në aspekte të ndryshme për të rritur eficienten dhe efektivitetin e të gjithë përdoruesve të këtij sistemi qofshin ata lexues të cilët përdorin PDA-të apo përdorues të cilët menaxhojnë proceset e ndryshme dhe kryejnë verifikime të nevojshme nga ndërfaqja e administrimit.

Sistemi MOBIREAD përdoret nga OSHEE Sh. a për administrimin e procesit të leximit të matësve të energjisë elektrike në të gjithë Shqipërinë. Programi përdoret nga specialistët që monitorojnë procesin nëpërmjet ndërfaqes backend dhe lexuesëve që kryejnë procesin e mbledhjes së të dhënave të matësve me anë të App Mobile duke përdorur aparatet mobile PDA.

OSHEE Group Sh.a është përcaktuar si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit. Në këtë kontekst OSHEE Group Sh.a duhet të auditojë sistemet në përdorim në mënyrë periodike, të marrë masa për përditesimin e tyre, të ketë një plan të menaxhimit të riskut dhe të raportojë po në mënyrë periodike në AKCESK.

Per sa mesiper keto procese duhet te kryhen nga nje operator i vetem, ndaj kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 18,800,000 (Tetembedhjete e teteqind milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2021, 2022, 2023. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet përkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e shërbimeve dhe cilësinë, kërkohet që OE ofertues të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën 18,800,000 (Tetembedhjete e teteqind milion) leke pa TVSH, duke qëndruar madje brenda normës prej 50% të vlerës së fondit limit që prokurohet, norme shumë më e ulët se ajo që përcaktohet si limit i mundshëm nga LPP 162/2020.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore,*”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 15,000,000 (Pesëmbëdhjetë milion) leke pa TVSH.

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohet vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësise dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkureshmerise që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura

dhe te informatizuara e teknologjise se larte dhe me impakt shume te madh financiar ne rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar ose me kontrate bashkepunimi jo më pak se 9 (nëntë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj).

Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e muait te fundit duke ju referuar dates se hapjes se ofertave, diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve, kontrates se punes ose kontrates se bashkepunimit e vlefshme per te gjithë kohezgjatjen e sherbimit objekt kontrate.

Këta punonjës duhet të kenë rolet dhe certifikimet si vijon:

- a. Të paktën 4 (katër) programues/zhvillues software ku të paktën 2 (dy) të jenë të certifikuar në implementim ose zhvillim të zgjidhjes softwerike së ofruar dhe të paktën 1 (një) të jetë certifikuar për zhvillimin ose administrimin e bazës së të dhënave, të paktën 1 (një) në programim app mobile android ose ekuivalent
- b. Të paktën 1 (një) menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist.
- c. Të paktën 1 (një) person të certifikuar në nivel profesionist në sisteme me arkitekturë të orientuar nga shërbimet.
- d. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për “container” si Docker ose ekuivalent
- e. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për “container orchestration” si Kubernetes ose ekuivalent.
- f. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për administrimin e sistemit të operimit.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

1. *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperme;*
2. *Kontratën/at e punes konform legjislacionit ne fuqi të lidhura me stafin e nevojshëm.dhe CV;*
3. *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit”.*

Në lidhje me certifikatat e kërkuara, pranohen dhe certifikatat ekuivalente të lëshuara nga institucione certifikuese kombëtare ose ndërkombëtare.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet

edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilën nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mësipërme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar, janë kryer në bazë të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialisteve. Diplomimi i punonjësve në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi përfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të ofrojë trajnim për përdoruesit.

- a) **Të paktën 4 (katër) programues/zhvillues software ku të paktën 2 (dy) të jenë të certifikuar në implementim ose zhvillim të zgjidhjes softwerike së ofruar dhe të paktën 1 (një) të jetë certifikuar për zhvillimin ose administrimin e bazës së të dhënave, të paktën 1 (një) në programim app mobile android ose ekuivalent**

Argumentim: Kriteri garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE Ofertues. Disponimi i 2 (dy) programues/zhvillues software të certifikuar garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK lidhur me upgrade dhe përmirësimet. Gjithashtu këta specialistë garantojnë vijueshmerinë normale të punës për gjatë gjithë periudhës së kontratës. Disponimi i 1 (një) programues/zhvillues software certifikuar për zhvillimin ose administrimin e bazës së të dhënave vjen si nevojë për të garantuar optimizimin, ndërhyrje të përgjegjshme në bazën e të dhënave si dhe për të garantuar performancë maksimale gjatë gjithë shtrirjes së kontratës pavarësisht shtimit të sasisë së të dhënave në të, pasi Mobiread është një sistem i cili përpunon miliona të dhëna të cilat rriten me miliona rekorde cdo muaj. 1 (një) programues për App mobile android ose ekuivalent kërkohet pasi Mobiread ka komponente shumë të rëndësishme app mobile që përdoret nga lexuesit e OSHEE, nëpërmjet PDA në terren, për të mbledhur të dhënat e matësve së energjisë elektrike.

- b) **Të paktën 1 (një) menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist.**

Argumentim: Ky kriter garanton AK që operatori ekonomik ka në përbërje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet konform të gjitha kërkesave dhe afateve të përcaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerzve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

c) **Të paktën 1 (një) person të certifikuar në nivel profesionist në sisteme me arkitekturë të orientuar nga shërbimet.**

Argumentim: Ky kriter vjen si nevojë për të garantuar ruajtjen funksionale dhe upgrade optimal të integritetit mes Mobiread dhe sistemeve të tjera sic shpjegohet në specifikimet teknike.

d) **Të paktën 1 (një) person të certifikuar për “container” si Docker ose ekuivalent.**

Argumentim: Kjo kërkesë lidhet ngushtë me specifikimet teknike dhe mund të gjendet të paktën në paragrafin me titull “Përdorimi i teknologjive “container””. Një punonjës me njohuri të tilla të certifikuara garanton AK për përbushjen e instalimit dhe konfigurimit në mënyrën më të mirë të container që do të përzgjidhjet nga OE.

e) **Të paktën 1 (një) person të certifikuar për “container orchestration” si Kubernetes ose ekuivalent.**

Argumentim: Kjo kërkesë lidhet ngushtë me specifikimet teknike dhe mund të gjendet të paktën në paragrafin me titull “Përdorimi i teknologjive “container orchestration””. Një punonjës me njohuri të tilla të certifikuara garanton AK për përbushjen e instalimi dhe konfigurimit në mënyrën më të mirë të “container orchestration” që do të përzgjidhjet nga OE.

f) **Të paktën 1 (një) person të certifikuar për administrimin e sistemit të operimit.**

Argumentim: Të gjithë instalimet dhe konfigurimet e të gjithë komponenteve të mjedisit ku ndodhet e instaluar zgjidhja do të kryhen nga OE. Sic përmendet edhe në specifikimet teknike, një nga detyrat në këtë kontratë është upgrade dhe instalimi i të gjithë komponenteve të nevojshëm për realizimin e kërkesave të AK të shprehura në specifikimet teknike të cilat do të kryhen nga OE në sistemin e operimit që ndodhet në makinën virtuale. Më tej edhe vet sistemi i operimit do të duhet të konfigurohet nga OE për t’iu përshtatur qëllimit dhe natyrës që ka Mobiread.

Listpagesa apo nje dokument vertetues i listes se personelit, ne muajin e fundit, vertetimi tatimor per nr total te personelit te kontraktorit, jane grupi i dokumentave teper te lehte per tu paraqitur paraprakisht nga OE bashke me formularin e ofertes tekniko-ekonomike dhe vetedeklarimet e tjera, ne menyre qe te behet nje vleresim sa me i drejte dhe profesional nga KVO.

Qëllimi dhe objektivi final i ketyre kritereve është mosnderprerja e shërbimeve shume te rendesishme te ofruara perdite nga punonjesit dhe sistemet teknologjike te Oshee Group sha, sigurimi i vijimësisë se punës, mos rrezikimi i ekspozimit të të dhënave konfidenciale që përmbajnë/grumbullojnë e menaxhojne këto sisteme dhe sigurisht minimizimi maksimal i humbjeve të pallogaritshme financiare zinxhir që do shkaktoheshin në rast ndërprerjeje të proceseve të përditshme te punës si rezultat i mos-kryerjes së këtij prokurimi, ne kuadër të progresit te vazhdueshëm e të pandalshem teknologjik faktik të platformave ekzistuese dhe atyre që do vijnë në të ardhmen e afërt për Oshee Group sha.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001:2015** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe **ISO 27001:2013** ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te shërbimeve qe do te marre përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi/distributori ose certifikatën e të drejtave të autorit për produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurorimi për territorin e Shqipërisë.

Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit/distributorit, autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritein Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sqarojme se:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës të mallrave/shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikepamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre mallrave/shërbimeve sipas kërkesave në specifikimet teknike.

Për të garantuar me sukses përmbushjen e të gjithë kërkesave teknike gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, për të garantuar zgjidhjen e problemeve të paparashikuara që mund të hasë OE gjatë kryerjes së proceseve të punës deri në dorëzim të plotë të kontratës, nevojitet të kenë mbështetje nga prodhuesi për rastet e përbaljes me situata të paparashikuara si dhe për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë fazës së realizimit të projektit.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për produktet software ose komponentet që ofrohen falas nga prodhuesi të cilat vetëm shpërndahen por nuk shiten, nuk është i nevojshëm autorizimi por mjafton që OE të përmendë emrin e komponentit, burimin ku do ta marrë psh website zyrtar, dhe një burim në internet ose dokument të vërtetueshëm nga AK ku përcaktohet që prodhuesi ose distributori i saj e ofron falas dhe lejon shërndarjen për këdo.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej sistemeve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore që zgjerojnë ato ekzistuese dhe upgrade (përmirësim) të sistemeve ekzistuese sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura,

standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Termat e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.